



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"UKSHIN HOTI" PRIZREN**

**DOKU
FEST**
International Documentary
and Short Film Festival

**FESTIVALI NDËRKOMBËTAR
I FILMIT DOKUMENTAR DHE TË
SHKURTËR**

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT "UKSHIN HOTI" PRIZREN

DHE

DOKUFEST

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Universitet Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt.	23.12.2019
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-484

Neni 1

Marrëveshja e Bashkëpunimit (në tekstin e mëtejme Marrëveshje) lidhet mes DokuFest, e përfaqësuar nga Drejtoresh i Ekzekutive Znj. Linda Llulla Gashi dhe Universitetit "Ukshin HOTI" i Prizrenit, përfaqësuar nga Rektori Prof. Asoc. Dr. Ismet Temaj.

Neni 2

Qëllimi i kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit është të përcaktojë kushtet e bashkëpunimit në mes të dy institucioneve për interesin reciprok.

Neni 3

DokuFest dhe Universiteti "Ukshin HOTI" i Prizrenit pajtohen që për interesa të përbashkëta të asistojnë, promovojnë, përkrahin dhe ngrisin nivelin e bashkëpunimit reciprok në mes të tyre, në funksion të zhvillimit të përgjithshëm edukativ, social dhe ekonomik, dhe ngritjen profesionale të studentëve të UPZ-së.

Neni 4

DokuFest dhe Universiteti "Ukshin HOTI" i Prizrenit së bashku do të kontribuojnë në drejtimin të zhvillimit, përkrahjes dhe promovimit të sektorit edukativ dhe profesional, ofrimin e shërbimeve përkatëse për këtë universitet, gjenerimin e punësimit dhe zvogëlimin e papunësisë. Në këtë aspekt, Universiteti i Prizrenit do t'iu ofrojë ndihmë shkencore-profesionale DokuFest me shërbimet e veta.

Neni 5

DokuFest dhe Universiteti "Ukshin HOTI" i Prizrenit pajtohen që në përgatitjen e propozimeve dhe realizimin e projekteve të përbashkëta, që kanë të bëjnë me promovimin e kulturës dhe në mënyrë të rregullt të këmbëjnë informatat e domosdoshme për implementimin projekteve të përbashkëta.

Neni 6

DokuFest do të pranojnë një numër të studentëve të Universitetit "Ukshin HOTI" të Prizrenit për të bërë praktikën profesionale nëpër zyrat e DokuFest dhe gjatë kohës së festivalit.

Neni 7

DokuFest dhe Universiteti "Ukshin HOTI" pajtohen që për nevoja të tyre të shkëmbejnë ekspertë dhe përvojat e tyre në fushat e caktuara, që kanë kapacitete dy palët.

Neni 8

DokuFest dhe Universiteti "Ukshin HOTI" pajtohen që të bashkëpunojnë në organizimin e përbashkët të shkollës verore ndërkombëtare në Prizren.

Neni 9

DokuFest dhe Universiteti "Ukshin HOTI" pajtohen për Shfrytëzimin e hapësirave infrastrukturore, sallave për mësim, amfiteatrove, etj., për realizimin e projekteve të caktuara në interes të përgjithshëm.

Neni 10

Universiteti 'Ukshin Hoti' pranon që DokuFest të organizojë shfaqje të filmave dokumentarë të kuruara enkas për drejtimet e Fakulteteve të Universitetit, që do të bazohen në metodologjinë e DokuFest dhe që janë në përputhëshmeri të plote me objektivat e Strategjisë së Arsimit të Lartë, e që nxisin punën kërkimore-shkencore, artistike dhe të inovacionit të Universitetit "Ukshin Hoti".

Neni 11

DokuFest dhe Universiteti "Ukshin HOTI" pajtohen që të bashkëpunojnë gjatë procesit të hartimit të programeve të caktuara studimore në kuadër të UPZ.

Neni 12

Marrëveshja ka afat vlefshmërie për periudhe 5(pesë) vjeçare të bashkëpunimit me mundësi vazhdimi, plotësim ndryshimi me pajtimin e dy palëve.

Neni 13

Marrëveshja e bashkëpunimit është e nënshkruar në dy kopje në gjuhën shqipe dhe dy kopje në gjuhën angleze. Në rast të mospërputhjes, vlen kopja në gjuhën shqipe.

Kjo marrëveshje hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Përfaqësuar nga:

Rektor:

Prof. Asoc. Dr. Ismet TEMAJ

Drejtoresh Ekzekutive:

Znj. Linda Llulla Gashi

Prizren, Dhjetor 2019

